
FJALORI ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR (2008-2009) SI FRYT DHE PASQYRUES I SHKENCËS SHQIPTARE

EMIL LAFE

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, SHQIPËRI
encikloped@yahoo.com

AKTET V, 4: 776-779, 2012

Prej dy vjetësh është në qarkullim “Fjalori enciklopedik shqiptar” (FESH), botim i ri në tri vëllime me mbi 3060 faqe dhe ilustrime të shumta. Ky fjalor është përgatitur në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë pas një pune komplekse disavjeçare të Qendrës së Enciklopedisë Shqiptare, të redaksive të 21 fushave tematike të Fjalorit, të Këshillit botues e të Redaksisë së përgjithshme dhe të disa qindra autorëve të zërave.

Dy kanë qenë kriteret udhëheqëse në hartimin e kësaj vepre: kriteri kombëtar dhe kriteri i objektivitetit shkencor e i vërtetësisë shkencore. Këto dy kritere nuk mund të ndahen njëri nga tjetri. Kombi shqiptar dhe territori i tij etnik janë vështruar në këtë vepër si një e tërë, me gjithë lëvizjet në konfiguracionin politik e shtetëror të kësaj ane të gadishullit tonë. Krahas kësaj në të gjitha hallkat e punës për këtë vepër janë bërë përpjekje për të dhënë një trajtim shkencor sa më objektiv, duke nxjerrë në pah ngjarjet e momentet historike dhe vlerat kulturore të popullit shqiptar. Është synuar të paraqiten arritjet më të reja të shkencave albanologjike në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni etj., si dhe arritjet e studiuesve shqiptarë në shkencat shoqërore, natyrore e teknike, në fushën e kulturës, të arteve e të sportit.

Fjalorit enciklopedik në tri vëllime vijon rrugën e çelur nga *Fjalori enciklopedik shqiptar* në një vëllim, i botuar në vitin 1985, i cili, si vepra e parë

enciklopedike në gjuhën shqipe, do të mbetet në historinë e shkencës e të kulturës shqiptare si çdo fillim pozitiv, që hap një rrugë të re. Por kjo vepër u përgatit në rrethana të reja historike-politike të brendshme e të jashtme dhe në pajtim me to ndryshon shumë nga fjalori i mëparshëm, si nga ana sasiore, ashtu edhe nga përmbajtja e zërave e nga mënyra e trajtimit të tyre. Në mënyrë të figurshme mund të thuhet se botimi i ri i *Fjalorit enciklopedik* ndryshon nga botimi i parë i tij ashtu siç ndryshojnë Bota dhe Jeta Shqiptare e kohës së sotme nga ato të një brezi më parë.

Ç’përfaqëson ky fjalor? “Fjalori enciklopedik” përfaqëson një vepër shkencore sintetike e përgjithësuese, që pasqyron Botën Shqiptare në tërësinë e saj që nga lashtësia deri në ditët tona, historinë e kombit shqiptar në tërësi dhe të trevave të tij etnike. Në *FESH* zë vend të gjerë veçanërisht pasqyrimi i gjithanshëm i jetës së shtetit shqiptar që me themelimin e tij më 28 Nëntor 1912. Po ashtu në të kanë gjetur pasqyrimin e duhur edhe historia e Kosovës pas vitit 1913 dhe Kosova si shtet i pavarur e sovran në ditët tona, historia dhe jeta e popullsisë shqiptare në Maqedoni e në Malin e Zi, ana gjeografike-natyrore e trojeve të saj të banimit, zhvillimet dhe arritjet e reja politike, ekonomike, arsimore e kulturore-shkencore. Arbëreshët e Italisë e të Greqisë dhe në përgjithësi Diaspora Shqiptare, e vjetra dhe e reja, veprimtaria e institucioneve dhe e figurave të njohura të saj,

janë vështruar si pjesë përbërëse e pandashme e Botës Shqiptare dhe kanë gjetur pasqyrimin e duhur në *FESH*. Kështu, në emërtimin *Fjalor enciklopedik shqiptar* përcaktimi *shqiptar* pasqyron në radhë të parë përmbajtjen e kësaj vepre: ajo ka të bëjë me kombin shqiptar dhe me trojet e tij etnike (pra, nuk është një vepër enciklopedike e tipit universal e hartuar në një vend të caktuar, siç është p.sh. Enciklopedia britanike, italiane, franceze etj.).

Ndër vështirësitë e shumta që duhen përballuar për hartimin e një vepre enciklopedike, dy janë ndër më të përgjithshmet: *së pari*, hartimi i listave të zërave që duhen përfshirë (zëra persona e jopersona); *së dyti*, hartimi i zërave në mënyrë të tillë që në sa më pak vend të thuhet të gjitha ato që duhen thënë. Nuk mund të thuhet se ia kemi dalë t'i kalojmë më së miri këto vështirësi, por vullneti i mirë dhe përpjekjet kanë qenë në shkallën më të lartë në të gjitha hallkat e punës.

Lënda e *FESH* është përgatitur nga redaksitë e 21 fushave tematike në pajtim me Platformën e punës të miratuar nga Redaksia e përgjithshme dhe në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën e Enciklopedisë Shqiptare. Këto redaksi janë paraqitur dhe në parathënien e veprës, si më poshtë:

- I. Redaksia e Arkeologjisë dhe e Historisë së Lashtë, e drejtuar nga akad. Muzafer Korkuti;
- II. Redaksia e historisë së Mesjetës e Hershme dhe e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, e drejtuar nga akad. Kristaq Prifti;
- III. Redaksia e Historisë Bashkëkohore, e drejtuar nga prof. Ana Lalaj;
- IV. Redaksia e Mbrojtjes, e Rendit dhe e Historisë ushtarake, e drejtuar nga prof. Ruzhdi Ramadani, gjeneral;
- V. Redaksia e Kulturës popullore, e drejtuar nga akad. Alfred Uçi;
- VI. Redaksia e Letërsisë, e drejtuar nga akad. Jorgo Bullo;
- VII. Redaksia e Gjuhësisë, e drejtuar nga prof. Seit Mansaku;
- VIII. Redaksia e Artit dhe e Kulturës, e drejtuar nga prof. Ferit Hudhri dhe prof. Josif Papagjoni;

IX. Redaksia e Gjeografisë, e drejtuar nga prof. Arqile Bërxfholi dhe prof. Farudin Krutaj;

X. Redaksia e Arsimit, e drejtuar nga i ndjeri akad. Bedri Dedja;

XI. Redaksia e Shtypit, e drejtuar nga prof.as. Bashkim Gjergji;

XII. Redaksia e Sporteve, e drejtuar nga prof. Lumturi Markola;

XIII. Redaksia e Drejtësisë, e drejtuar nga akad. Luan Omari;

XIV. Redaksia e Sociologjisë dhe e Filozofisë, e drejtuar nga akad. Zija Xholi;

XV. Redaksia e Ekonomisë, e drejtuar nga i ndjeri akad. Hekuran Mara;

XVI. Redaksia e Industrisë, Gjeologjisë dhe Minierave, e drejtuar nga akad. Teki Biçoku dhe prof. Besnik Ostrosi;

XVII. Redaksia e Ndërtimit, e Komunikacionit dhe e Ekonomisë komunale, e drejtuar nga i ndjeri akad. Besim Daja;

XVIII. Redaksia e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Pylltarisë, e drejtuar nga akad. Mentor Përmeti;

XIX. Redaksia e Mjekësisë dhe e Farmaceutikës, e drejtuar nga i ndjeri akad. Josif Adhami;

XX. Redaksia e Biologjisë, e drejtuar nga i ndjeri akad. Teki Tartari;

XXI. Redaksia e Kimisë, Fizikës, Matematikës dhe Informatikës, e drejtuar nga akad. Dhimitër Haxhimihali.

Këshilli botues i veprës, i përbërë nga akad. Ylli Popa (kryetar), prof. Arqile Bërxfholi, akad. Jorgo Bullo, prof. Emil Lafe, akad. Luan Omari, akad. Kristaq Prifti, akad. Eduard Sulstarova, e ka shqyrtuar me durim e me përgjegjësi gjithë lëndën dhe ka vendosur përfundimisht për të, por gjithnjë në marrëveshje me redaksitë përkatëse.

Fjalori i ri enciklopedik përmban rreth 7250 zëra, ndër të cilët mbi 2360 zëra persona, d.m.th. një e treta, në krahasim me rreth 5000 zëra të *FESH* të botuar më 1985, ndër të cilët vetëm rreth 700 zëra persona, d.m.th. një e shtata. Duke pasur parasysh se nga *FESH*-i i vitit 1985 janë lënë jashtë me dhjetëra zëra, mund të thuhet se kemi një shtesë prej mbi 2300 zërash të rinj. Kjo shtesë nuk ka të bëjë vetëm me përfshirjen e ngjarjeve e

të dukurive të reja në Shqipëri, që i përkasin periudhës nga viti 1985 deri në ditët tona. Duke marrë parasysh realitetin e ri të krijuar në ditët tona për popullin shqiptar në Ballkan, veçanërisht pas çlirimit të Kosovës në qershor të vitit 1999 dhe shpalljes së Republikës së Kosovës si shtet i pavarur e sovran më 17 shkurt 2008, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare dhe redaksitë e fushave, me përkrahjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, bënë shumë përpjekje që në këtë botim të ri të FESH të pasqyrohen gjerësisht gjithë trevat shqiptare, duke shtuar në mënyrë të ndjeshme zërat për qytetet, fshatrat, komunat dhe për njësitë e gjeografisë fizike (male, fusha, lugina, qafa, gryka, lumenj etj.). Kështu në FESH janë pasqyruar 30 komunat dhe qendrat komunale të Kosovës, si dhe komunat me shumicë shqiptare në Maqedoni, në Malin e Zi e në luginën e Preshevës; janë përfshirë monumente të natyrës e të kulturës të këtyre trevave, shumë ngjarje historike, të vjetra e të reja, ndër to edhe lufta e UÇK-së dhe fushata e NATO-s për çlirimin e Kosovës, së cilës i kushtohet edhe një zë i madh i përgjithshëm si shtet i pavarur e sovran. Kjo punë është përbërë me bashkëpunimin individual të dhjetëra e dhjetëra specialistëve autorë zërash, sidomos nga Kosova, me redaksitë e fjalorit dhe me Qendrën e Enciklopedisë të ASHSH (dëshira dhe përpjekja dhe jonë për të pasur si mbështetje Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për zërat që i takojnë Kosovës, nuk gjeti përkrahje prej saj). Në FESH-in e ri janë shtuar në mënyrë të ndjeshme edhe zërat për institucionet arsimore, kulturore-artistike, shkencore, si dhe për personalitete e figura historike ose të fushave të ndryshme të kulturës, artit, shkencës, sportit etj. nga gjithë hapësira shqiptare.

Në FESH-in e ri janë përfshirë në mënyrë më të gjerë se më parë edhe ngjarje të jetës ndërkombëtare, si edhe një varg personalitetesh të huaja politike, shkencore, nga bota e artit e nga fusha të tjera, që kanë pasur lidhje të drejtpërdrejta me vendin tonë ose kanë ndikuar në zhvillime të ndryshme të jetës shqiptare, veçanërisht ata që kanë përkrahur aspiratat dhe

përpjekjet e popullit tonë për një Shqipëri të lirë, të përparuar e demokratike.

Në pasqyrën më poshtë paraqitet me përafërsi sasia e zërave të hartuar për FESH-in sipas fushave tematike:

Fusha	Nr. i zërave gjithsej	Nga këta zëra persona
Arkeologjia dhe Historia e lashtë	279	71
Historia e Mesjetës dhe e Rilindjes	589	308
Historia bashkëkohore	657	433
Mbrojtja, Rendi, Historia ushtarake	288	173
Kultura popullore	354	75
Letërsia	263	228
Gjuhësia	170	97
Artet, Kultura	490	306
Gjeografia	1453	35
Arsimi	200	68
Shtypi	285	46
Sportet, Fizikultura	137	80
Drejtësia	235	35
Sociologjia, Filozofia	30	11
Ekonomia	191	53
Gjeologjia, Minierat, Industria	326	59
Ndërtimi, Komunikacioni, Ekonomi komunale	240	61
Bujqësia, Blegtoaria, Pylltaria	356	82
Shëndetësia, Farmaceutika	346	121
Biologjia	173	25
Kimia, Fizika, Matematika, Informatika	127	43

Për realizimin e FESH kanë bashkëpunuar dhe kanë dhënë ndihmesë të veçantë punonjës shkencorë të instituteve dhe qendrave kërkimore-shkencore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, pedagogë të departamenteve të Universitetit të Tiranës, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të Universitetit Bujqësor të Tiranës, të universiteteve të tjera të vendit, të Akademisë së Arteve, të Akademisë Ushtarake, të Akademisë së

Rendit, si dhe specialistë të cilësuar nga një numër institucionesh të tjera kërkimore-shkencore. Bashkëpunëtorët nga Universiteti i Prishtinës, nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe nga institucione të tjera të Kosovës, po ashtu nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, nga Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë dhe nga institucione të tjera në Maqedoni, në Malin e Zi, nga Arbëreshët e Italisë, si edhe disa albanologë të huaj, kanë dhënë të gjithë së bashku ndihmesë të pazëvendësueshme, duke hartuar zëra nga fushat e tyre të punës dhe duke dërguar materiale e të dhëna të nevojshme për plotësimin e një numri zërash të tjerë.

Në këtë mënyrë mund të thuhet se ky “Fjalor enciklopedik” është vepra e parë enciklopedike me shtrirje mbarëkombëtare, e hartuar me forca të përbashkëta të gjithë shqiptarëve, është fryt i përbashkët i shkencës shqiptare pa kufij shtetërorë dhe pasqyron, sipas natyrës së tij, arritjet e kësaj shkençe. Prandaj dhe unë, i udhëhequr nga ideja e integritit të shkencës shqiptare dhe me përvojën e bashkëpunimit konkret ndërmjet shkencëtarëve shqiptarë rreth kësaj vepre themelore, e përkraha që në fillim idenë e krijimit të Alb-Shkencës, si institucion që ndihmon ecjen tonë në drejtimin e duhur.

Zgjidha të flas në këtë takim për Fjalorin enciklopedik, jo vetëm sepse kjo vepër dhe puna për hartimin e saj janë në pajtim me temën e Takimit tonë të sivjetshëm. Arsyeja tjetër është se një fjalor enciklopedik nuk është kurrë një vepër e përfunduar, si p.sh. përmendorja e Skënderbeut, që qëndron e do të qëndrojë përherë ashtu. Fjalori enciklopedik është një vepër në zhvillim, që do të ripërtërihet herë pas here, pa prituri të kalojnë përsëri 25 vjet. Fjalori enciklopedik ka një rreze të gjerë veprimi në opinionin publik e shkencor dhe duhet t’i nënshtrohet gjyqimit e vlerësimit të tij. Unë, si

redaktor i përgjithshëm i veprës, por edhe kolegët e mi të Qendrës së Enciklopedisë, prof. dr. Hysen Kordha, përgjegjës i sektorit të shkencave shoqërore, dhe dr. Vilma Proko, përgjegjëse e sektorit të shkencave teknike e natyrore, i mirëpresim opinionet kritike, sepse vetëm kështu mund të përmirësohet kjo vepër në botimet e ardhshme dhe t’i shërbejë më mirë publikut të interesuar si një bazë të dhënash, përshkrimesh e vlerësimesh për morinë e zërave që përmban. Për të ndihmuar që edhe anëtarët e Alb-Shkencës të sjellin ndihmesën e tyre të cilësuar, po vë në dispozicion të tyre listat e zërave sipas fushave tematike, në mënyrë që çdo studiues i interesuar të ketë mundësi të vështrojë në tërësi fushën e specialitetit të vet. Seksione të veçanta të Alb-Shkencës mund të organizojnë diskutime rreth një a më shumë fushave të fjalorit. Duhet të pranojmë se përvoja e botimeve enciklopedike origjinale në gjuhën shqipe është e paktë. Prandaj diskutimet do të jenë kurdoherë të dobishme.

Me këtë rast shpreh bindjen time se hartuesit dhe përgatitësit e kësaj vepre i kanë dhënë popullit shqiptar, veçanërisht brezave të rinj, një dëshmi të qartë të pasurisë së vlerave tona historike e kulturore, një dëshmi të lashtësisë dhe të njësisë së fisit shqiptar, një dëshmi të mundësive për të ecur më shpejt përpara, një dëshmi dinjiteti njerëzor e kombëtar. Prandaj për vepra të tilla ia vlen të mendosh, të diskutosh, të punosh. Ato janë vepra që përfaqësojnë shkencën dhe kulturën kombëtare shqiptare, janë përgjegjësi e të gjithëve dhe nder i të gjithëve!